

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Detajet/ Vrasje me armë zjarri në Sarandë, plagoset dhe një kalimtar. Viktimës iu zu pritë nga autorët
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/20/detajet-vrasje-me-arme-zjarri-ne-sarande-plagoset-dhe-nje-kalimtar/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 08:30:54 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	20 shtator 2026, 08:05:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 20 shtator 2026, 08:04:00 UTC → 20 shtator 2026, 08:06:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8c29a4b659cac6d39f06dcbe3d2f3524b99d36953d59396d63fe9f59d3995c8b
TEKSTI	543e772c3bd00eb7c1c7a2d1d997caceb3ed1611424f50b2cf9ccf71e84d1689
PAMJA	37803b171d10d0320ecf08d805132483cef939e7fa8e7c51a2c22d0fc27fd768

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	85fdb90ee94749f840ec758cf12233704b29ffaefdefba361e6165c01d3b3f67
E MËPARSHMJA	61955f6a15e79e35efe706e9441441a7cfec0c207fe95946f1710369b0301739
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/85fdb90ee94749f840ec758cf12233704b29ffaefdefba361e6165c01d3b3f67>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET KRYESORE TË FUNDIT

Detajet/ Vrasje me armë zjarri në Sarandë, plagoset dhe një kalimtar. Viktimës iu zu pritë nga autorët

20/09/2026 10:05



Ishte ulur në një lokal në qendër të qytetit dhe po pinte kafën bashkë me një shok. Pak minuta më vonë, Artan Murtaj, 44 vjeç, i njohur edhe si "Tani Ruzhdiu", u ngrit nga tavolina dhe doli nga lokali.

Nuk kishte bërë më shumë se disa metra, kur dy persona të maskuar, të hipur në një motor, iu afruan dhe hapën zjarr në drejtim të tij. Fillimisht 44-vjeçari u qëllua me dy plumba.

I plagosur, Murtaj tentoi të largohej me vrap, por autorët vijuan të qëllonin. Ai mbeti i vdekur në vend, në kryqëzimin pranë ish-agjencisë, ndërsa autorët u larguan me motor.

Të shtënat krijuan panik në një prej zonave më të frekuentuara të Sarandës.

Plumbat prekën edhe biznese pranë vendit të atentatit, ndërsa një 75-vjeçar, Xhevdet Skëndaj, që ndodhej rastësisht në zonë, mbeti i plagosur. I moshuari u transportua fillimisht për ndihmë mjekësore dhe, për shkak të gjendjes së tij, u dërgua me helikopter drejt Tiranës për trajtim të specializuar.

Në vendngjarje u gjetën dhe u sekuestruan prova që pritet t'i shërbejnë hetimit. Një element i rëndësishëm për grupin hetimor janë kamerat e shumta të sigurisë në këtë zonë. Policia ka sekuestruar pamjet e kamerave të bizneseve dhe ambienteve përreth, me qëllim ndjekjen e lëvizjeve të autorëve, para dhe pas atentatit.

Menjëherë pas ngjarjes janë ngritur pika kontrolli në Sarandë dhe në akset rrugore që lidhin qytetin me Gjirokastrën. Policia ka ushtruar kontrolle për identifikimin dhe kapjen e dy autorëve, të cilët vijojnë të jenë në kërkim.

Ndërkohë, skena e krimit është rrethuar nga policia dhe vijojnë veprimet hetimore për dokumentimin e plotë të ngjarjes.

Në vendin e atentatit ka mbërritur edhe nëna e 44-vjeçarit. E tronditur nga ajo që kishte ndodhur, ajo ka parë të birin të pajetë në rrugë, duke shpërthyer në britma.

Murtaj ishte djali i vetëm i familjes, ndërsa dy vite më parë familja kishte humbur edhe vajzën e saj. Artan Myrtaj ishte një emër i njohur për policinë për shkak të precedentëve të mëparshëm penalë.

Ai rezultoi i dënuar më herët për "vjedhje", ndërsa emri i tij ishte përfshirë edhe në plagosjen me armë të 17 korrikut 2025 në Sarandë, ku u plagosën Ernest Lama dhe Gëzim Hajdaraj.

Për këtë ngjarje, Ramadan Zoto ndodhet në burg, ndërsa Murtaj dhe Klaus Jacaj, të akuzuar për "përkrahje të autorit të krimit", ishin liruar pak kohë më parë. Në kërkim për këtë dosje vijon të jetë Erjon Canaj.

I Kryesore



Foto/ Viktima që u ekzekutua njëhej me emrin "Tani Ruzhdiu", plagosja e dy personave me armë zjarri në Sarandë solli sagën e hakmarrjes

10:53

Vrasja e 44-vjeçarit dhe plagosja e kalimtarit në Sarandë, reagon Policia: Janë ngritur pika kontrolli në drejtim të Vlorës dhe Gjirokastrës

10:58

Kontrabandë mallrash nga Greqia, arrestohen 2 persona në Gjirokastrë, sekuestrohen mbi 22 mijë euro dhe 100 steka cigare

09:44

Dy gjermanë bëjnë "shaka" në Luvër, ngjisin dy piktura me shirit pranë Mona Lizës, por... përfundojnë në komisarjat

22:55

Lazio nuk fal në transfertë, Zaccagni dhe Noslin ngjitin Gattuso-n në majën e Serie A

22:43

I Më të lexuarat

Bordi i Transparencës ndryshon çmimet e karburanteve, nafta dhe benzina pësojnë rënie

U tallën me Çerçiz Topullin, jep dorëheqjen kreu i Agjencisë së Trashëgimisë Kulturore në Gjirokastrë

Fredi Beleri "mburr" deputetin e Agimit të Artë dhe sulmon drejtësinë greke, tërheq deklaratën pas reagimeve të forta nga PASOK

Bashkëshortja e Alban Hoxhës humbi jetën pas lindjes së djalit, Gjykata e Lartë rrezon rekursin e dy mjekëve

U vra me armë zjarri në rrugë, ja kush është viktima në Sarandë, rezultoi i arrestuar në 2025

Spektakël i dyshes Salah-Muçi dhe Trabzonsporit, kampionët e Galatasarayt pësojnë disfatën e parë

Detajet/ Vrasje me armë zjarri në Sarandë, plagoset dhe një kalimtar. Viktimës iu zu pritë nga autorët

Sapo ishte ulur për kafe në një lokal, 44-vjeçari tentoi t'i largohej me vrap autorëve, por u vra në mes të rrugës

Foto/ Viktima që u ekzekutua njëhej me

Policia vijon kërkimet për kapjen e autorëve, ndërsa pamjet e kamerave të sekuestruara pritet të jenë një prej provave kryesore për zbardhjen e itinerarit të tyre dhe identifikimin e personave që kryen atentatin.

Top Channel

emrin "Tani Ruzhdiut", plagosja e dy personave me armë zjarri në Sarandë solli sagën e hakmarrjes

Dy Gjermani në zgjedhje/ Mrekullia ekonomike e Mecklenburgut dhe kriza e strehimit në Berlin, çfarë do të përcaktojë beteja zgjedhore e të dielës

I Aktualitet »



U kthye në 'makthin' e bizneseve, arrestohet Kumrie Zika. Ja si kryente vjedhjet 39-vjeçarja në subjektet që punësohej

20/09 13:15




Biznes në oborret e shkollave, nis aksioni për lirin e hapësirave të zëna në institucionet arsimore në Shkodër

20/09 12:56



Atentati në Sarandë, këmbësori që mbeti i plagosur nisjet drejt Tiranës me helikopter

20/09 12:11



Angli/ Katër 17-vjeçarë shqiptarë të "zhdukur", kërkohet ndihma publikut për t'i gjetur (Fotot)

20/09 12:06



Vrau gruan se ndihmonte vajzën/ Detaje nga krimi brenda familjes në Tiranë, Hysni Patushi qëlloi bashkëshorten se kujdesej për 4 nipërit

20/09 12:05



Aksident në aksin Fier-Seman, drejtuesja e mjetit dërgohet me urgjencë në spital

20/09 12:03

I Kryesore »



NATO mirëpret marrëveshjen për Groenlandën, Trump: SHBA do të ketë kontroll të përhershëm të sigurisë

20/09 13:29




VIDEO/ "Për Enverin yll e dritë...", Biblioteka e Lushnjës përgjeshtron lajmin e Saimir Korreshit: Ja si qëndron e vërteta

20/09 12:41



Atentati në Sarandë, këmbësori që mbeti i plagosur nisjet drejt Tiranës me helikopter

20/09 12:11



Angli/ Katër 17-vjeçarë shqiptarë të "zhdukur", kërkohet ndihma publikut për t'i gjetur (Fotot)

20/09 12:06



Vrau gruan se ndihmonte vajzën/ Detaje nga krimi brenda familjes në Tiranë, Hysni Patushi qëlloi bashkëshorten se kujdesej për 4 nipërit

20/09 12:05



Sapo ishte ulur për kafe në një lokal, 44-vjeçari tentoi t'i largohej me vrap autorëve, por u vra në mes të rrugës

20/09 11:38

Na ndiqni:

Top Channel


@topchannelalbania

@tchbreakingnews

Top Channel

I Video »






Top News – Pakt i ri për komunitetet lokale/ Turizmi, Rama: Fond për shoqatat që mbrojnë territorin



Top News – Makina përfundon në kanal/ Aksident në aksin Fier–Seman, drejtuesja e mjetit në spital



Top News- Arabia nën sulm, flakë e tym mbi Riad / Huthit sulmojnë kryeqytetin saudit, dronë e raketa



Top News – Turqia ‘hyn në luftë’ me Huthit / Në ndihmë të Arabisë Saudite sipas paktit të mbrojtjes



Top News – Media persekutoi Harry-n dhe Meghan-in / Vëllai i Dianës bën krahasime me princeshën



Top News – Zgjedhjet në Rusi në ditën finale / Prova e mbështetjes për luftën e Putinit në Ukrainë

Lajme	Bota	Sport	Pop News	Programe	Top Channel
Lajmet e fundit	Opinion	Kombëtarja	Showbiz	Big Brother VIP	Rreth Top Channel
Politikë	Koment	Kategoria Superiore	Lifestyle	Për'puthen	Topin e kam unë – Apliko tani!
Kronikë	Kosova dhe Rajoni	Kategoria e Parë	Fashion	Shqipëria LIVE	Kontakt
Aktualitet	Shkencë dhe Teknologji	Premier League	Shëndeti	Fiks Fare	Puno në Top Channel
Ekonomi	Auto	La Liga	Dieta	Video	Privacy Policy & Terms of Use
Sociale		Serie A	Receta gatimi	Të gjitha programet	Aksesueshmëria
Video		Shumësportësh		Guida TV	
Top News LIVE		Sport Gossip			

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.